

**PANDËSHKUESHMËRIA NË KOSOVË:
PASURIA E PAJUSTIFIKUESHME**

Ky projekt është mbështetur nga: Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Prishtinë.



Kingdom of the Netherlands

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë ato të KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamje të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Prishtinë.

Përgatitur nga: Ariana Qosaj-Mustafa

Hulumtimi i mbështetur nga: Violeta Haxholli dhe Kastriot Jahaj

Të drejtat autoriale © 2013 i ka KIPRED. Çdo të drejtë e mban autori. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet a të ruhet diku me qëllim rishfrytëzimi, të emetohet në kurrfarë forme apo me kurrfarë mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, inçizues apo tjetër, pa u dhënë paraprakisht leja me shkrim nga botuesi. Ju lusim që për informata të kontaktoni në info@kipred.org ose +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Rr. "Rexhep Mala" Nr 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel dhe Fax: +381 38 227 778

www.kipred.org

PËRMBAJTJA

I.	Përmbledhje ekzekutive	4
II.	Kërkesat e Brukselit për Kosovën në luftën kundër korrupsionit	5
	(A) Gjendja aktuale e çështjeve në luftën kundër korrupsionit	6
III.	Pandëshkueshmëria e zyrtarëve të lartë: Pasuria e pajustificueshme	8
IV.	Hetimi dhe konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme	12
	A) Reforma ligjore 2011-2013	13
	B) Gjendja aktuale e çështjeve	14
	C) Sfidat e vazhdueshme në zbatim	15
V.	Rruga Përpara	16
	Shtojca 1	19
	Tabela 1: Pasuria e përgjithshme/Ministrat e Kabinetit Qeveritar	19
	Tabela 2: Pasuria e përgjithshme e deputetëve të Kuvendit të Kosovës të zgjedhur rastësisht	20

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pas shpalljes së pavarësisë më 2008, Kosova iu nënshtua reformave juridike dhe ligjore të udhëhequra nga institucionet e Kosovës nën mbështetjen e gjerë të komunitetit ndërkombëtar. Përveç kësaj, edhe misioni më i madh i PPMS-së të BE-së – EULEX vazhdon të jetë i vendosur me mandatin për monitorim, mentorim, këshillim dhe atë ekzekutiv në fusha të caktuara të luftimit të krimit të organizuar dhe krimeve financiare dhe ekonomike. Edhe pse me ndihmën më të lartë financiare të BE-së për kokë banori në Ballkanin Perëndimor, përpjekjet në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë mbeten të pasuksesshme.¹ Mungesa e vullnetit politik nga ana e një qeverie shpesh e mbishkruar si e korruptuar, pastaj mungesa e mbështetjes së mjaftueshme financiare dhe në përgjithësi ndikimi i kufizuar i Kuvendit të Kosovës dhe shoqërisë civile për të rritur llogaridhënien dhe transparencën e institucioneve të Kosovës kanë sjellë Kosovën në një fazë të korrupsionit politik nga ana e pushtetit ekzekutiv.

Reformat ligjore dhe reformat e politikave të ndërmarra në vitet 2011-2013 sikurse verifikimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, hartimi i kodit penal dhe kodit të procedurës penale e pasuar nga një strukturë e re e gjyqësorit që nga viti 2013, të gjitha kanë avancuar krijimin e infrastrukturës themelore për sundimin e ligjit në Kosovë. Sidoqoftë, rezultatet në krijimin e një shteti funksional, të bazuar në sundimin e ligjit në praktikë janë larg nga përmbushja. Siç thuhet nga Raporti i Progresit të BE-së 2013, Kosova si çështje prioritare duhet të ofroj dëshmi për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duke fuqizuar legjislacionin dhe zbatimin e tij. Gjithashtu duhet të tregojë vullnet politik dhe profesional për të ndërprerë ciklin e ndërhyrjeve politike ndaj gjyqësorit dhe për të forcuar kapacitetet e gjyqësisë për t'u përgjigjur një presioni të tillë, në mënyrë që të sigurojë zbatimin efektiv të legjislacionit.²

Në përgjithësi, hetimi dhe ndjekja penale e pasurisë së pajustificueshme të zyrtarëve të lartë pothuajse nuk ka ekzistuar fare në mungesë të iniciativës nga sistemi prokurorial. Kultura e pandëshkueshmërisë kundrejt individëve të fuqishëm të elitës politike në pushtet vazhdon 14 vjet pas intervenimit ndërkombëtar në Kosovë. Në rastet kur kanë ndodhur hetimet e krimeve ekonomike ose të shpërdorimit të detyrës zyrtare urdhrat për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë së fituar nga një shkelje e tillë janë urdhëruar pa bazën e duhur ligjore. Rastet nën hetim të raportuara nga të dhënat zyrtare të organeve të zbatimit të ligjit dhe shërbimit prokurorial që rezultojnë nga kërkesat e liberalizimit të vizave për Kosovën, kanë qenë të regjistruar si një prioritet, megjithatë deri në çfarë mase këto hetime janë efektive dhe të paanshme sipas kërkesave të BE-së për Kosovën, mbetet për t'u vlerësuar. Edhe pse këto struktura kanë vazhduar të tregojnë rezultate në rritjen e numrave dhe realizimit së rasteve, Kosova mbetet prapa në implementimin e plotë të kërkesave.

¹ Gjykata Evropiane e Auditorëve Raporti Special Nr.18 “European Union Assistance to Kosovo related to the Rule of Law,” fq. 6 Përmbledhje Ekzekutive. Shiko në <http://eca.europa.eu/portal/pls/portal/docs/1/19168748.PDF>

² Shih faqe 6 dhe 12, Raportin e Progresit për Kosovën 2013 të Komisionit Europian, në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf

II. KËRKESAT E BRUKSELIT PËR KOSOVËN NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Më shumë se pesë vite pas pavarësisë, Kosova vazhdon të jetë e renditur lartë kur bëhet fjalë për nivelin e korrupsionit, si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Pavarësisht nga iniciativat e shumta dhe miratimi i ligjeve, zyrtarët qeveritar vazhdojnë të raportohen pothuajse në baza ditore në media në çështje të lidhura me korrupsion. Përkundër shumë nismave Transparency International Index³ ka refuzuar që të promovojë përpjekjet e QeK dhe perceptimet e korrupsionit vazhdojnë ta radhisin Kosovën në vendin e 105-të në rangun botëror me Algjerinë, Armeninë, Bolivinë, Gambinë, Malin, Meksikën dhe Filipinet me 34 pikë nga 100 të mundshme, si kategoria më e ulët në krijimin e një ambienti të pastër nga korrupsioni.

Duke adresuar kushtet teknike dhe nivelin e korrupsionit në Kosovë, që janë vlerësuar si rrezik për sigurinë e BE-së, Udhërrëfyesi i BE-së për Liberalizimin e Vizave për Kosovën dhe Studimi i Fizibilitetit për Kosovën kanë përcaktuar rreth 150 kritere për Kosovën në mënyrë që të avancojë në procesin e saj për lëvizje të lirë në BE dhe atë të integritimit. Si çështje parësore, institucionet e Kosovës janë këshilluar të sigurojnë dëshmi konkrete të rezultateve në luftën e tyre kundër korrupsionit. Kjo nuk do të përfshinte vetëm të dhënat e rasteve të hetuara por një përqindje të suksesshme të ndjekjeve penale dhe dënimeve duke përfshirë zyrtarët e lartë të përfshirë në korrupsion.

Përmbushja reale e këtyre kërkesave do të mbështettë shtetin e ri të Kosovës në shndërrim në një shtet të qëndrueshëm për qytetarët e vet. Ndalimi i korrupsionit, posaçërisht në nivelin e zyrtarëve të zgjedhur,⁴ duke përfshirë kërkesat si forcimin e Agjencisë Kundër-Korrupsion në verifikimin e pasurisë së zyrtarëve publik, një koordinim më i mirë në mes të organeve për zbatimin e sundimit të ligjit, hetimet e paanshme komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit duke siguruar statistika të besueshme për korrupsionin dhe miratimi ose rishikimi në rast nevojë i kornizës ligjore anti-korrupsion, si dhe bashkëpunimi i mirë me EULEX-in janë kërkesa të domosdoshme për Kosovën për të shfaqur gatishmërinë për luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Qeveria e Kosovës ka qenë efiçase në propozimin e legjislacionit të ri në përmbushjen e kërkesave të BE-së për Liberalizimin e Vizave me miratimet e fundit nga Kuvendi i Kosovës të një pakoje të ligjeve që trajtojnë çështje të tilla siç janë trafikimi i qenieve njerëzore, proceset e azilit, financimi i partive politike dhe siguria e dokumenteve.⁵ Ky punim analizon thelbësisht nëse iniciativat e fundit të qeverisë janë në të njëjtën vijë me kërkesat e parashtruara më lartë.

³ Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit vlereson shtetet në shkallë prej 0 (shumë të korruptuara) deri në 100 (shumë të pastra). Shih Transparency International, Corruption Perceptions Index për 2012, <http://www.transparency.org/cpi2012/results>, 2011, <http://www.transparency.org/cpi2011/results> dhe 2010, <http://www.transparency.org/cpi2010/results>

⁴ Shih Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin lidhur me Studimin e Fizibilitetit për një Marrëveshje të Stabilizimit dhe Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf dhe Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave me Kosovën

http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_travel/visa_liberalisation_with_kosovo_roadmap.pdf

⁵ Shih ligjet e miratuara në uebfaqen e Kuvendit të Kosovës: Ligji për të Huajt, Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji për Bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Ligji për Azil, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit dhe Ligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_s_2013_07_31_10_5118_al.pdf

(A) Gjendja aktuale e çështjeve në luftën kundër korrupsionit

Kosova ka vazhduar të investojë minimalisht në gjyqësor duke ndarë vetëm 0.47% të buxhetit të PBB-së. Si krahasim, shpenzimet kapitale të qeverisë kanë qenë më shumë se 11.2% të PBB-së, ku më shumë se 40% të mjeteve janë shpenzuar në një projekt të vetëm investimi, atë të autostradës me Shqipërinë. Korrupsioni vazhdon të konsiderohet si njëri nga faktorët pengues në mes tjerash edhe në zhvillimin ekonomik dhe të biznesit në Kosovë.⁶ Rryshfeti është një ndër llojet më të shpeshta të korrupsionit e shpërhapur mes bizneseve private në Kosovë. Zyra e OKB-së për Krime dhe Droga (UNODC) në raportin e tyre të fundit shpalosi të dhena për ndikimin e korrupsionit në ndërmarrjet private,⁷ statistika shqetësuese që tregojnë se bizneset paguajnë rryshfet në mesatare prej 7.7 here në vit ose japin një rryshfet në çdo shtatë javë. Më shumë se gjysma e rryshfeteve (50.1%) kërkohen nga zyrtarët publik derisa 38% e bizneseve japin rryshfet me iniciativën e tyre. Zyrtarët të cilëve më së shpeshti iu jepet mito janë zyrtarët doganorë (1.9%), zyrtarë të tatimeve (1.8%), zyrtarë lokal dhe komunal.⁸ Si arsye për mitdhënie këto biznese rendisin faktorë të ndryshëm si: fuqia e madhe e këtyre zyrtarëve, mungesa e integritetit të zyrtarëve, pagat e ulëta të zyrtarëve publik, dhe ndikimi i individëve të fuqishëm pasuar nga mungesa e llogaridhënies (Ibid).

Presidentja e Kosovës ka themeluar Këshillin Kundër-Korrupsion në Shkurt 2012, për të forcuar luftën kundër korrupsionit në Kosovë me një mbështetje të madhe të komunitetit ndërkombëtar dhe SHBA-së në veçanti.⁹ Sidoqoftë, me kalimin e kohës Këshilli zvogëloi rolin e tij pa fuqi të vërtetë të Presidentes për të kërkuar rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit. Duke mbetur më shumë një portretizim vizual i rezultateve sesa fakteve konkrete të rezultateve pas krijimit të tij në 2012, Këshilli i Presidentes ka dështuar të permbush mandatin në koordinim dhe veprime duke rënë në raportim të thjeshtë dhe duke u takuar rrallë vetëm një herë apo dy herë në vit.¹⁰ Ligjet kryesore të sponsorizuara nga qeveria si i shumë debatuar Ligji mbi Amnistinë që përfundimisht u ndryshua në mënyrë qenësore si jo-kushtetues me vendim të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës si dhe Ligji për Deklarimin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik nuk ishin nën vëmendjen e duhur e as të shqyrtuara nga Këshilli i Presidentes.

Numri i rasteve është rritur kohëve të fundit me Policinë e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit të Kosovës me nxitim ofron statistika mbi rastet e ndjekura penalisht të korrupsionit, duke u bazuar në kriteret e BE-së për Liberalizimin e Vizave. Strukturës gjyqësore është vazhduar që t'i bëhet presion, me mungesë të iniciativës së prokurorisë dhe policisë për të filluar hetimet e rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar kur bëhet fjalë për hetimin e pasurisë së pa justifikueshme të zyrtarëve të lartë. Duke pohuar se nuk kanë bazë të mjaftueshme ligjore për të hetuar këto

⁶ Investimet kanë vazhduar të bien nga viti 2005 me 2012 si vitin më të ulët në investimet e huaja direkte në Kosovë në 4.3% të PBB-së. Me më shumë se 100.000 raste që presin ekzekutimin nga ana e gjyqësisë së Kosovës, investimet në Kosovë kanë qenë në rënie. Shih fq. 11, 22 dhe 23, Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën 2013, në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf

⁷ Shih Biznesi, Korrupsioni, dhe Krimi në Kosovë: Ndikimi i rryshfetit dhe krimeve tjera në ndërmarrje private, Raporti i UNODC 2013 në http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Kosovo_Business_corruption_report_EN.pdf.

⁸ Po aty.

⁹ Shih deklaratat e lëshuara nga Presidentja e Kosovës mbi mbështetjen e premtuar dhe nënshkruar nga Znj. Hillary Clinton, ish Sekretare e Shtetit e SHBA-ve dhe Prokurori i Përgjithshëm i SHBA-ve Z. Eric Holder pas takimeve të mbajtura në SHBA gjatë vizitës më 2011. Shih Deklaratat zyrtare të Presidentes në <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2105> dhe konferencën për shtyp në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës me rastin e kthimit të Presidentes nga vizita në SHBA, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2110>

¹⁰ Gjatë 2013-ës Këshilli u takua vetëm njëherë edhe pse niveli i Presidentes me krijimin e tij parasheh takime në çdo tre muaj nëse ngrihet nevoja. Gjithashtu e shënuar në fq. 13 në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën 2013 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf

raste,¹¹ prokuroria dhe policia kanë qenë aktive në hetimin e rasteve të tjera të korrupsionit. Përqendrimi ka qenë kryesisht në rastet e ish zyrtarëve të lartë, të cilëve iu mungon mbështetja politike e qeverisë aktuale si në rastin e aktakuzës ndaj Fatmir Limajt ish nën-kryetar i partisë në pushtet PDK (Partia Demokratike e Kosovës), ose Ilir Tolaj dhe Bujar Bukoshi ku është theksuar se është bërë përzgjedhja selektive e hetimeve.

Në rastet e tjera siç është vërejtur në Raportin e Progresit të KE-së lidhjet e udhëheqësisë së policisë dhe nivelit politik kanë vazhduar të jenë të afërta.¹² Kjo ka çuar në një rritje të numrit të rasteve të raportuara lidhur me hetimin e korrupsionit pavarësisht nga hetimet e ndikuara drejtpërdrejt politikisht por gjithashtu të ndikuara nga mungesa e vullnetit politik për të hetuar rastet e tjera të zyrtarëve të lartë që janë të afërt me elitën e qeverisë aktuale.¹³ Kosovës do t'i duhet të punojë shumë që të jetë në gjendje të prodhojë struktura besnike ndaj shtetit më shumë se sa ndaj partive të caktuara politike në pushtet.

E përcjellë me instruksione të qarta të qeverisë për t'i dhënë përparësi hetimit të korrupsionit, zyra e Prokurorit Publik ka punuar me vetë iniciativë për të krijuar një bazë të të dhënave me të dhënat e rasteve të hetimeve, padive dhe dënimeve.¹⁴ Baza e të dhënave është krijuar pa ndihmën financiare të qeverisë, nga Zyra e Prokurorit Publik që është bazuar tërësisht në kapacitetet e veta për ta ndërtuar atë, gjë që ka bërë që baza e të dhënave të përballet me sfida në mbledhjen e informatave dhe kompletimin e saj.¹⁵ Burimet e prokurorisë vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme pasi që numri i prokurorëve që merren me rastet e korrupsionit është akoma i ulët. Deri në Tetor 2013 ka pasur 124 prokurorë për tërë Kosovën duke bërë numrin e vogël të prokurorëve një sfidë të vazhdueshme me jo më shumë se njëzet prokurorë që merren me korrupsionin si çështje me përparësi pavarësisht përfshirjes se tyre edhe me raste të tjera.¹⁶ Edhe pse numri i zyrtarëve policor që hetojnë korrupsionin dhe krimet ekonomike është rritur dukshëm prej rreth 96 hetues për krime ekonomike dhe korrupsion në staf total prej 127,¹⁷ burime të mjaftueshme nuk i ofrohen shërbimeve prokuroriale.

QeK ka vazhduar të ndajë vetëm 3% të buxhetit vjetor të Kosovës për financimin e Gjykatave dhe Prokurorisë Shtetërore¹⁸ duke e rrezikuar në thelb autonominë dhe pavarësinë e strukturave prokuroriale dhe gjyqësore, ku mungon vullneti politik për të bërë ndryshime për një shtet ku sundon ligji. Kjo qeveri ka deklaruar publikisht se do të mbështes fuqizimin e institucioneve për sundim të ligjit, por megjithatë ka punuar në mënyrë regresive në lejimin e këtyre strukturave që të jenë të pavarura në përpjekjet e tyre. Gjithashtu edhe në Raportin e fundit të Progresit të BE-së për Kosovën thuhet se ka vazhduar presioni politik kundrejt gjykatësve dhe prokurorëve që nuk janë të mbrojtur në mënyrën e duhur nga shteti me gjykime që vazhdojnë të mbahen në

¹¹ Intervistë e KIPRED me përfaqësuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, korrik 2013.

¹² Raporti i Progresit i KE për Kosovën 2013, fq.49

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf

¹³ Intervistë e KIPRED , menaxhimi i nivelit mesatar të hetimeve brenda Agjencisë për zbatimin e ligjit në Kosovë, tetor 2013.

¹⁴ Intervistë e KIPRED me zyrtarë të Zyrës së Prokurorëve Shtetëror, qershor 2013.

¹⁵ Intervistë e KIPRED me këshilltarin e EULEX-it në KPC, qershor 2013.

¹⁶ Komunikim telefonik i KIPRED me zyrtar të lartë të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, nëntor 2013. Numri do të rritet për 25 prokurorë në fillim të janarit 2014. Për krahasim Kosova ka 7.1 prokurorë për 100.000 banorë nga 1,739.000 banorë ndërsa Hungaria ka 17,3, Mali i Zi 13.4, Danimarka 10.3, etj. Shih fq.6 e botimit të KIPRED "Trekëndëshi i Brishtë: Kordinimi i policisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë procedurës penale në Kosovë" (2010), në http://www.kipred.org/advCms/documents/975_The_Fragile_Triangle.pdf

¹⁷ Takimi i KIPRED-it me shefin e Departamentit të Drejtorisë së PK e krimeve ekonomike dhe korrupsionit, shtator 2013.

¹⁸ Përlllogaritje e KIPRED-it nga buxheti i Kosovës 2012 në <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiqendrore.aspx>

godina të papërshtatshme.¹⁹ Kjo gjendje e punëve ka vazhduar t'i dëmtoj strukturat duke krijuar një ndjenjë besnikërie dhe varësie të gjyqësorit dhe prokurorisë nga qeveria më shumë se sa t'i ndërjegjësoj në gëzimin e titujve, që kanë si institucione të pavarura dhe të paanshme ashtu siç kërkohet nga BE-ja. Besnikëria ka rezultuar më shumë në interes të elitës së caktuar të korruptuar në pushtet e cila vazhdon të mbahet gjallë me kulturën e pandëshkueshmërisë nga hetimi dhe ndjekja penale.

Monitorimi i BE-së mbi implementimin e kërkesave për Liberalizimin e Vizave dhe Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim me Kosovën që së shpejti do të negociohet, duhet të shqyrtojë me kujdes të dhënat e siguruar nga shteti dhe të kërkojë që lufta kundër korrupsionit duhet të përfshijë dhe synojë të gjitha elitat politike në Kosovë dhe jo të shihet si një prioritet afat-shkurtër për QeK. Duhet të shikohet si proces reformativ për të ndërtuar hetime dhe ndjekje penale të paanshme të zhvilluara nga struktura të pavarura dhe profesionale e të mbështetura me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare. Implementimi i një kërkesë të tillë të BE-së e mbështetur me presion të fuqishëm publik për transparencë dhe llogaridhënie duhet që në afat të shkurtër të kërkojë thyerjen e kulturës së pandëshkueshmërisë për elitën politike që ka vazhduar të jetë në strehë të sigurt nga ndjekja penale derisa është në pushtet.

III. PANDËSHKUESHMËRIA E ZYRTARËVE TË LARTË: PASURIA E PAJUSTIFIKUESHME

Ndërmjet viteve 2008 dhe 2012, Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) ka vërejtur ndryshime të shprehura në deklarinë e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, me 9 deklarime që kanë pësuar ndryshime në vlera milionëshe. Pas verifikimit të plotë AKK ka identifikuar ndryshime të shprehura në 149 raste. Në tërësi 51 raste janë dërguar në Njësinë Financiare të Inteligjencës meqë dyshimet u rritën me rritjen e pasurisë së deklaruar me raste të tjera të dërguara për kontroll të konfliktit të interesit.²⁰ Gjatë 2012-ës, AKK ka arritur të verifikojë pasurinë e 800 zyrtarëve në të gjitha institucionet, derisa shumica e deklarimeve me ndryshime të shprehura ishin të 38 zyrtarëve nga qeveria.²¹ AKK kishte kapacitet t'i verifikojë vetëm 20% të pasurisë së deklaruar të të gjithë zyrtarëve të lartë publik, duke përfshirë zyrtarë qeveritar, megjithëse kjo paraqiti nevojën që institucionet qeverisëse duhet të kalojnë nëpër një hetim të kujdesshëm nga AKK si të përfshirë direkt në marrjen e vendimeve më të mëdha për Kosovën.

Gjatë 2013-ës, QeK ndërmoi amandamentimet e Ligjit për Deklarimin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publik duke e arsyetuar me nevojën që t'i japin disa 'dhëmbë' ligjit dhe të përmirësojnë ligjin në pajtim me Kodin e ri Penal të Kosovës që ka penalizuar deklarinë e rrejshëm apo mos-deklarinë e pasurisë nga zyrtarët e lartë. Mirëpo iniciativa është marrë në drejtim plotësisht të kundërt me qëllimin parësor. Ajo ka shfaqur një tendencë të Qeverisë së Kosovës që fillimisht të lejojë që AKK të jetë ligjërisht e obliguar të verifikojë vetëm 20% të të gjitha institucioneve si dhe në të njëjtën kohë të provojë të mbyllë plotësisht nga shqyrtimi publik deklarinë e pasurive nga zyrtarët. Kjo e fundit është bërë me arsyetimin se deklarimi publik i pasurisë së zyrtarëve shkel të drejtën e privatësisë së zyrtarëve publik e mbështetur nga Agjencia për Mbrojtjen e të

¹⁹ Raporti i Progresit i KE për Kosovën, 2013 fq.3 në

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf

²⁰ Shih raportin vjetor 2012 të Agjencisë Anti-Korrupsion, http://akk-ks.org/repository/docs/ENG_Raporti_2013-vp.pdf

²¹ Të dytët pas qeverisë me ndryshimet më të mëdha në deklarinë e pasurisë janë ndërmarrjet publike, 22 nga 52.98% e kontrolluar. Në http://akk-ks.org/repository/docs/ENG_Raporti_2013-vp.pdf

Dhënave²² e ndikuar nga qeveria. Përkundër rritjes së gjerë të pasurisë së zyrtarëve të lartë nëse analizohet nga 2010 deri 2013,²³ qeveria ka bashkëpunuar me Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të reflektuar rekomandimet e tyre për të mbyllur plotësisht informimin publik për pasurinë e zyrtarëve të lartë.

Vetëm pas përpjekjeve të koordinuara të grupeve të shoqërisë civile dhe argumentimit se mbyllja nga informimi publik do të ishte një frenim për transparencën e Kosovës në qeverisje, Ministria sponsorizuese u tërhoq nga qëllimi i saj parësor.²⁴ Pasuritë e deklaruar kanë vazhduar të jenë në dispozicion të publikut vetëm pas shqyrtimit të vazhdueshëm dhe presionit publik.

Në shkelle të plotë të kërkesave të ligjit, deklaratimet e tanishme të pasurisë nga legjislatura e tanishme e Kosovës nuk paraqiten në një mënyrë transparente.²⁵ Formularët e deklaruar nga deputetët përmbajnë të dhëna jo të plota posaçërisht kur bëhet fjalë për origjinën e pasurisë së tyre. Nga 41 deputetë, 22 deputetë (ose më shumë se gjysma) për pasuri të patundshme kanë deklaruar prejardhjen e pasurisë si trashëgimi familjare ose pronë të përbashkët familjare pa cekur vitet e zotërimit të pronës. Në mënyrë të ngjashme për zyrtarët e kabinetit qeveritarë nga 22 të analizuar 12 prej tyre (apo më shumë se gjysma) kanë deklaruar trashëgimi për disa nga pasuritë e tyre, kryesisht pasurive të patundshme. KIPRED ka shikuar deklaratimin e pasurive të 41 deputetëve, duke zgjedhur gjysmën e deputetëve nga secili grup parlamentar nga 4 partitë më të mëdha politike. Në shumicën e rasteve të përmendura më lartë pasuria e përgjithshme e rritur është e pajustificueshme nëse krahasohet me të ardhurat e tyre vjetore.

Edhe pse transparencja e degës së legjislativit është pjesë e standardeve të qeverisjes së mirë që duhet të synohen nga deputetët, në praktikë deputetët më të pasur nuk ofrojnë origjinën e pasurisë. Prej 2013-ës dështimi për të deklaruar pasurinë brenda afatit kohor është i dënueshëm me Kodin Penal të Kosovës me një gjobë apo me burgim deri në tri vjet. Shumica e deputetëve deklarojnë trashëgim apo prona të përbashkëta familjare si mënyra të zotërimit të pasurisë por duke mos e specifikuar vitin e zotërimit të trashëgimisë apo blerjes së pronës. Edhe pse AKK kërkon që deklaratime të tilla të zyrtarëve duhet të bëhen në pajtim të plotë me kërkesat e ligjit, versionet e përmirësuara të deklaratimeve nuk janë në dispozicion në internet.

KIPRED ka bërë një mostër të përzgjedhjes dhe ka analizuar deklaratimet e pasurive të deputetëve nga partitë në pushtet dhe në opozitë në bazë të ulëseve në Kuvendin e Kosovës.²⁶ Në rastin e partisë PDK që qeverisë, ka deputet që nuk i kanë deklaruar pasuritë e tyre.²⁷ Deputetë të tjerë siç

²² Kreu i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që është trup i Kuvendit të Kosovës, është një ish anëtar dhe kryetar i Kuvendit Komunal të Shtimes, nga partia politike në pushtet PDK. Shih për shembull artikullin në <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,6165>

²³ Shih Deklarimet Vjetore të Pasurisë 2010, 2011, 2012 dhe 2013 në ueb faqen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1178>

²⁴ OShC që i kanë ofruar komente të shkruara Ministrin Kuçi në draft ligjin e tyre të fundit ishin: KIPRED, Grupi për Studime Ligjore dhe Politike, Instituti Demokratik i Kosovës, Iniciativa për Stabilitetin e Kosovës, Lëvizja FOL.

²⁵ Ligji Nr. 04/L-050 mbi Deklarimin, origjinën dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe mbi deklaratimin, origjinën dhe kontrollin e dhuratave të të gjithë zyrtarëve publik, në http://www.md-ks.org/repository/docs/declaration_origin_and_controle.pdf.

²⁶ Kanë qenë në total 41 deputetë të analizuar nga të cilët 19 deputetë nga partia më e madhe parlamentare Partia Demokratike e Kosovës (PDK), 12 deputetë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), 7 deputetë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) dhe 3 deputetë nga partia Vetëvendosje (VV).

²⁷ Për shembull Z. Berat Buzhala ka deklaruar publikisht refuzimin e tij për të deklaruar pasurinë e tij më 2013 në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Agjencia Kundër Korrupsionit tashmë ka shtypur akuzat kundër tij dhe rasti ka qenë në procedim. (Intervistë e KIPRED me kreun e Agjencisë Kundër Korrupsionit, qershor 2013). Më 2012, më shumë se 300 zyrtarë kanë pasur raste në gjykata për shkak të dështimit për të raportuar pasurinë e tij siç kërkohet me ligj. Shih Raportin e Agjencisë Anti-Korrupsion mbi analizën e ‘ Si e kanë trajtuar gjykatat dështimin e zyrtarëve për të raportuar pasurinë e në 2012?’ në <http://www.akk-ks.org/repository/docs/denimet.pdf>.

është kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së ka deklaruar pasurinë e tij të patundshme në vlerë prej 1.350.330 €, por origjina dhe viti i zotërimit të pasurive të tij në shumicën e pasurive të deklaruara nuk është në dispozicion. Në një tjetër shembull prej deputetëve të PDK-së,²⁸ aksionet në biznese janë deklaruar p.sh. 50% të aksioneve, duke e lënë anash vlerën monetare të fituar nga aksionet dhe pasurinë totale. Një tjetër deputet nga partia opozitare LDK,²⁹ ka deklaruar 6,601,155 € pasuri të patundshme, pa e deklaruar qartë datën e zotërimit p.sh. vitin e origjinës.

Për shembull nga katër partitë më të mëdha politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, KIPRED ka vënë re rritje dhe rënie të pasurisë së pajustificueshme kur krahasohen me vitet e ndryshme të raportimit. Një deputet nga partia në pushtet PDK në 2010-2011 kishte një rritje të pasurisë prej 428% nga 268,863.80 € në 1,419,822.00 €. ³⁰ Më vonë në mes të 2011 dhe 2013 dallimi i vërejtur ishte i -1%. Në mënyrë të ngjashme një tjetër deputet nga partia LDK kishte raportuar në vitin 2010 shumën prej 498,730.35 € pasuri ndërsa në vitin 2011 pasuria kishte rritje për 258% në 1,784,700.00 €. ³¹ Rritja e mëvonshme 2011-2013 përfundoi në përgjithësi 5%. Një deputet nga AAK gjithashtu tregoi një rritje prej 820,300.00 € në 1,008,900.00 € me një rritje prej 23% në mes të 2011 dhe 2012. ³² Në rastin e partisë VV, një deputet ka deklaruar 10,306,136.00 € ³³ me një rënie prej -40% të pasurisë në 6,896,116.00 €, pa përshkrim të qartë për vendndodhjen e pasurisë që i kishte rënë.

Modeli në raportimin e uljes së pasurisë shpjegohet me faktin se pasuria e deklaruar nga deputetët është dhënë në mënyrë të përafërt duke mos deklaruar përlllogaritjen e rritjes së pasurisë gjatë viteve dhe çmimin real të pasurisë. Kjo është si rezultat i mungesës në ligj që nuk siguron një mekanizëm të qartë që do të garantonte se pasuria e secilit zyrtarë të lartë publik do të kontrollohet kundrejt kriterëve thelbësorë të vlerës së pasurisë, rritjes vjetore të pasurisë dhe çmimit real të pasurisë. Verifikimi i tanishëm i pasurisë nga Agjencia Kundër Korrupsion thjesht përfshinë verifikimin e deklarimeve/formularëve të paraqitura nga zyrtarët e lartë publik, pa pasur një kontroll thelbësor në secilën pronë të deklaruar. Sidoqoftë, organizatat e shoqërisë civile³⁴ u takuan dhe hartuan komentet me rekomandime që duhet futur një mekanizëm në ligj i cili kërkon nga Agjencia Kundër Korrupsionit që të verifikojë përmbajtjen e pasurisë së deklaruar nga zyrtarët e lartë publik kundrejt çmimit të tyre të vërtetë dhe ekzistencës, duke siguruar që prona e deklaruar është kontrolluar kundrejt standardeve të çmimeve substanciale dhe reale. Megjithatë ky rekomandim nuk është marrë për bazë nga Ministria e Drejtësisë në ligjin e ndryshuar kohëve të fundit.

Shqetësimi i OShC kishte të bënte me faktin se kur fillojnë mandatin të gjithë zyrtarët e lartë mund që gjithashtu të rrisin vlerën e vërtetë të pasurive të tyre dhe me deklarimin e pasurive ndër vite do të deklaronin rënien e pasurisë së tyre. Nëse deklaramet e fundit të pasurisë në 2013 kontrollohen kundrejt pasurisë së deklaruar në vitin 2012 ka një mesatare të rritjes prej 11% për

²⁸ Shih deklarimin e pasurisë të deputetit Shaip Muja në <http://akk-ks.org/?cid=1,1192&path=Kuvendi>

²⁹ Shih deklarimin e pasurisë të deputetit Hashim Deshishku në <http://akk-ks.org/?cid=1,1192&path=Kuvendi>

³⁰ Nga 268,863.80 € të deklaruara në 2010, në 2011 ishin 1,419,822.00 € të deklaruara, me të hyra nga paga prej 27,863.80 €, shih në http://akk-ks.org/2010/Kuvendi_i_Republikes_se_%20Kosoves/Deputetet_e_Kuvendit/2010_Xhavit%20Haliti%20-%20Deputet.pdf.

³¹ Shih deklarimin e pasurisë të deputetit Lutfi Haziri në, http://akk-ks.org/2013/Kuvendi/Lutfi_Haziri.pdf

³² Shih deklarimin e pasurisë të deputetit Burim Ramadani në, http://akk-ks.org/2013/Kuvendi/Burim_Ramadani.pdf

³³ Shih deklarimin e pasurisë të deputetit Florin Krasniqi në, http://akk-ks.org/2011/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Florin_Krasniqi.pdf

³⁴ Grupi përbëhej nga anëtarët e OJQ-ve: KIPRED, Grupi për Studime Politike dhe Juridike, Instituti Demokratik i Kosovës, Iniciativa Kosovare për Stabilitet dhe Lëvizja FOL.

të gjithë deputetët. Në 2011-2012 rritja për 22 deputet nga 41 deputet të analizuar tregon një rritje prej 14% nga 34,304,596.12 € në 36,645,798.55 €. Në vitin 2013 ka pasur një rënie në -1% të pasurisë së përgjithshme nga 36,645,798.55 € në 32,659,903.97 €. ³⁵ Keqinformimi i qëllimshëm i deputetëve se pasuria e tyre është duke rënë përgjatë viteve e ulë vëmendjen dhe presionin publik. Me ligjin e tanishëm që kaloi leximin e parë së fundi nga Kuvendi i Kosovës, duke lënë vetëm 20% të pasurive të zyrtarëve të lartë të verifikohen nga AKK, probabiliteti i heqjes së këtij trendi të raportimit të zyrtarëve të lartë mbetet e vogël, duke vazhduar pandëshkueshmërinë e milionave të fituar nga marrja e detyrës.

Në përgjithësi mungesa e raportimit apo raportimi i falsifikuar nga ana e zyrtarëve të lartë penalizohet me Kodin Penal të Kosovës që nga 2013-ta. Sidoqoftë raporti i fundit i AKK mbi zbatimin e ligjit gjatë 2012-ës ka shfaqur një trend të vazhdueshëm të gjykatave që të zbatohet dobët ligji në fuqi më 2012. Nga 306 raste të zyrtarëve të lartë publik të paraqitur nga AKK-ja në gjykata më 2012, buxheti i Kosovës është dëmtuar shkaku i dënimeve të ulëta të shqiptuara nga gjykatat. Me 42% të rasteve të pa zgjidhura nga gjykatat, rastet e tjera janë dënuar në total prej 80,870.00 € nga aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë. Nëse gjobat e përmirësuara do të ishin lëshuar nga gjykatat një total prej 765,000.00 € do të transferoheshin në buxhetin e Kosovës. ³⁶ Këto vendimet e fundit të gjykatave kanë treguar mungesë vullneti nga trupat gjyqësor që të zbatohet në tërësi ligji mbi veprat penale të disa zyrtarëve publik. Gjykatat kanë pasur një rol diskreditues në zbatimin e ligjit ndaj zyrtarëve të lartë publik duke vazhduar ta mbajnë gjallë kulturën e pandëshkueshmërisë.

³⁵ Me përjashtim të një deputeti me një rritje të konsiderueshme në pasuri pasi ka pasqyruar pasurinë nga statusi i saj sapomartuar. Shiko në, http://akk-ks.org/2013/Kuvendi/Vjosa_Osmani.pdf.

³⁶ Një tjetër masë që nuk është zbatuar nga gjykatat është masa e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik për një vit për zyrtarët e lartë. Shih publikimet e AKK në <http://www.akk-ks.org/repository/docs/denimet.pdf>

IV. HETIMI DHE KONFISKIMI I PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME

Grupet e organizuara kriminale dhe zyrtarët e korruptuar kanë përdorur shpëlarjen e parave në mënyrë që të infiltrojnë dhe fitojnë ndikim ekonomik në shoqëri.³⁷ Në vitin 2000, Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit e përkufizoi ‘pasurimin e paligjshëm... si një rritje e madhe e pasurisë së një zyrtari publik që ai ose ajo nuk mund ta justifikojë në mënyrë të arsyeshme në raport me të ardhurat e tij ose të saj të ligjshme’, duke iu nënshtruar parimeve fundamentale ligjore të shtetit dhe të drejtave të garantuara kushtetuese.³⁸ Në SHBA dhe shumicën e shteteve të BE-së penalizimi i pasurimit të paligjshëm do ende për tu trajtuar derisa shumica e shteteve në zhvillim dhe ekonomitë të mëdha në rritje tashmë e kanë penalizuar atë.³⁹ Një term kundërtënës shpesh me konkludime jo të lehta për qasje të ndryshme shtyri shumë shtete të kenë qasje të ndryshme në luftimin e pasurimit të paligjshëm. Varësisht nga niveli i korrupsionit dhe krimit të organizuar në një shtet përgjigjet ishin ndërtuar në përputhje me rrethanat.

Fenomeni i pasurisë së pajustificueshme në Kosovë ka qenë në rritje nga fillimi i qeverisjes ndërkombëtare në Kosovë. Pandëshkueshmëria kundër zyrtarëve të lartë publik një traditë e trashëguar nga epoka e UNMIK-ut (1999-2008) ka vazhduar gjatë dhe pas mbikëqyrjes ndërkombëtare të Kosovës së pavarësuar rishtas. Me Kosovën që po permireson marrëdhëniet e saja me BE-në duke filluar negociatat mbi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, marrëdhëniet kontraktuale të Kosovës dhe BE-së janë vënë në një ritëm të njëtrajtshëm. Në vitet e fundit hetimi i pasurisë së pajustificueshme ka qenë në qendër të debatit për luftimin efektiv të korrupsionit dhe krimit të organizuar nga grupet e shoqërisë civile. E pasuar nga presioni publik dhe i mediave hetimet e pasurisë së pajustificueshme ishin vendosur gjithashtu si një kriter nga BE për Udhërrëfyesin e Liberalizimit të Vizave për Kosovën.⁴⁰ Si një iniciativë për ti dhënë fund pandëshkueshmërisë nga pasuria e pajustificueshme e shtuar ndër vite, BE-ja ka ofruar disa Direktiva⁴¹ si udhëzim se si institucionet e Kosovës saktësisht duhet t’i përmbushin këto kërkesa të BE-së.

Pasuria e pajustificueshme e rritur në Kosovë ka qenë alarmuese në vitet e fundit që prej fillimit të deklarimit publik të pasurisë në ueb faqen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Disa media kanë raportuar për rritje të pashpjegueshme të pasurisë në krahasim me të ardhurat vjetore të zyrtarëve. Gjithashtu janë hetuar një numër investimesh në biznese të ndryshme në ndërtimtari, sektorin e energjisë, tregtinë me naftë ose aktivitete të tjera ekonomike të udhëhequr nga kushërinjtë të afërt apo biznesmenë anëtarë të familjes së ngushtë të elitës aktuale politike.⁴²

³⁷ Fq. 9 të “Financial Investigations and Confiscation of Proceeds of Crime” Manual Trajnues për Zbatimin e Ligjit dhe Gjyqësisë, Robert Golobinek për Këshillin e Evropës, 2006.

³⁸ Neni 20 i Konventës së OKB-së Kundër Korrupsionit në http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf

³⁹ On the take: Criminalizing Illicit Enrichment to fight Corruption, publikimet e Bankës Botërore (dhjetor 2012) në <http://issuu.com/world.bank.publications/docs/9780821394540>

⁴⁰ Shih fq. 11 të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave me Kosovën në http://ec.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_travel/visa_liberalisation_with_kosovo_roadmap.pdf

⁴¹ Shih për shembull Vendimin Kornizë mbi luftimin kundër krimit të organizuar (2008/841/JHA), Direktiva e Tretë kundër shpëlarjes së parave (Direktivat 2005/60/EC dhe 2006/70/EC), Korniza dhe Vendimet e Këshillit mbi ngrirjen dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (Vendimet Kornizë 2001/500/JHA, 2003/577/JHA, 2005/212/JHA, 2006/783/JHA dhe Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA), Vendimi i Këshillit mbi bashkëpunimin FIU (Vendimi 2000/642/JHA), dhe Vendimi Kornizë mbi korrupsionin në sektorin privat (2003/568/JHA) në pg. 11 të Liberalizimit të Vizave me Udhërrëfyesin e Kosovës.

⁴² Shih për shembull Artikullin e Preportit, KEK-Korporata e Korrupsionit në <http://www.preportr.com/sq/Asetet-publike-dhe-privatizimi/KeK-Korporata-e-Korrupsionit-176> dhe artikullin në Gazeta JNK ‘Vëllai i Kryeministrit Ndërton Komplex Banesor’ (prill 2012) në <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,1952>.

Strategjia për organizimin politik të qeverisë aktuale është cituar si marrëdhënie *klienteliste* me që investimet publike janë bazuar gjithashtu në interesat e partive në pushtet më shumë se sa nevojave të qëndrueshme për zhvillim të qytetarëve.⁴³ Një numër i raporteve hetimore nga mediat kanë shfaqur një strukturë të bizneseve të favorizuara nga partitë kryesore politike që ishin mbështetëse gjatë fushatave zgjedhore dhe favore (ndere) të tilla janë kthyer pas marrjes së qeverisjes në nivelet lokale apo qendrore (Ibid).

Për shkak të vendosjes së kriterëve të BE-së qeveria ka ndërmarrë disa iniciativa për të adresuar përmbushjen e këtyre kriterëve. Një reformë ligjore është iniciuar gjatë 2011-ës për të adresuar kriteret e BE-së për të filluar konfiskimin e pasurisë së fituar prej veprave kriminale. Për shkak të mungesës së iniciativës prokuroriale për të hetuar dhe ndjekur rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit në të kaluarën, hezitimi nga gjykatësit për të zbatuar këto dispozita, e ka bërë konfiskimin pothuajse të padukshëm.

Për këtë arsye një pako reformash ligjore janë ndërmarrë duke i përcaktuar krimet korruptive në veçanti si dhe duke përcaktuar procedurat e konfiskimit të pasurisë në procesin penal. Risitë në kodin e ri penal lejojnë që gjatë hetimeve penale apo dorëzimit të aktakuzës prokurorët kanë të drejtë të kërkojnë sekuestrim të përkohshëm vetëm sipas urdhrit të gjykatës. Ajo çka mbetet si në kodet e kaluara penale është se pasuria e paligjshme mund të konfiskohet vetëm pas aktgjykimit përfundimtar të gjykatës.

A) Reforma ligjore 2011-2013

- (1) Më 2011 qeveria filloi hartimin e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar në Kosovë me një qasje anti-mafia⁴⁴ sidoqoftë ligji përfundoi duke u ndryshuar dhe sapo u vendosën kriteret për Liberalizimin e Vizave, u ndërmor një qasje më e butë nga qeveria.
- (2) Nga fundi i 2011-ës qeveria hartoi Ligjin mbi kompetencat e zgjeruara në Konfiskimin e Pasurive të fituara me vepër penale⁴⁵ e miratuar më 2012. Hartimi i ligjit anti-mafia u zëvendësua me këtë fragment legjislativ me që qeveria u deklarua e shqetësuar rreth përfshirjes së mundshme të të drejtave të njeriut për konfiskim më të gjerë të pabazuar në aktgjykimin e plotfuqishëm në rast të përdorimit në Kosovë. Deklaratat u ndryshuan nga ministri Kuçi duke thënë se gjyqësori i Kosovës nuk ka traditë të mjaftueshme ligjore dhe se konfiskimi i dobisë pasurore pa dënim mund të aplikohet në mënyrë të gabuar.⁴⁶ Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit i vetëdijshëm për implikimet e mundshme të drejtave të njeriut ka hezitur të shtyjë hartimin e ligjit me autoritet më të gjerë konfiskimi

⁴³ Kompanitë ndërtimore nga Prizreni, që njihet si bastion i partisë në pushtet PDK-së kanë përfituar më shumë gjatë vitit 2010-2011 nëse krahasohet me kompanitë e komunave të tjera të Kosovës. Hulumtimi i Forumit 2015 ka shfaqur një mospërputhje në mes të kompanive të Prizrenit që kanë përfituar nga ministritë e ndryshme kur krahasohen me kompanitë vetëm nga Prishtina. Vetëm 16 kompani nga Prizreni kanë fituar 71 milion Euro nga 42 oferta kur krahasohen me 61 kompani në Prishtinë që kanë fituar 121 milion Euro nga 123 oferta. Gjithashtu kompani nga Shtimja, Skenderaj, Drenasi e Ferizaj kanë marrë 30 milion Euro më shumë se sa komunat e Podujevës, Deçanit, Istogut dhe Junikut. Shih publikimin 'The weakest Link in Kosovo's Democracy,' Forumi 2015. Artan Haracija dhe Lorik Bajrami (2012) 'Public Investments based on interests of the political parties in power, not on the plans and Laws: purchasing political land with public funds.'

⁴⁴ Shih Strategjia Ligjvënëse e Qeverisë së Kosovës në

http://www.gapmonitor.org/data/Image/Strategjia_Legjislative_2011.pdf

⁴⁵ Shih Ligjin në http://www.md-ks.org/repository/docs/Ligji_per_Kompetencat_e_zgjeruara_%28shqip%29.pdf

⁴⁶ Shih deklaratën nga Ministri Kuçi në një debat publik të organizuar nga Ministria e drejtësisë lidhur me draft ligjin e kompetencave të zgjeruara të konfiskimit. Artikulli i plotë në <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,108606>

për shërbimet prokuroriale të Kosovës.⁴⁷ Kjo i mundësoi qeverisë që ti shmanget shpejtë përgjegjësisë për të hartuar një pako ligjesh të stilit anti-mafia.

- (3) Në Janar 2013 kodi i ri i Penal dhe Kodi i Procedurës forcoi procedurat për konfiskim të të ardhurave të krimit që tashmë kanë ekzistuar në Kodet paraprake të 2003-ës.
- (4) Në Tetor 2013, partia Vetëvendosje ka iniciuar një ligj për të ofruar konfiskim të padënueshem dhe hetimin e pasurisë së pajustificueshme duke e zhvendosur barrën e provës tek zyrtari i lartë i dyshuar për korrupsion me prokurorinë që fiton më shumë kompetencë në hetimin e rritjes së dyshuar të pasurisë. Megjithatë duhet të shikohet me kujdes shkelja e të drejtave të njeriut me këtë ligj duke përfshirë shkeljen e parimit të ligjshmërisë të iniciuar me draft-ligj.

B) Gjendja aktuale e ceshtjeve

Për shkak të kërkesave të BE-së shërbimet hetimore dhe prokuroriale të Kosovës janë përqendruar në masë të madhe në rritjen e të dhënave të rasteve të hetuara për korrupsion dhe krim të organizuar. Shumica e rasteve të vogla të korrupsionit janë trajtuar nga prokuroria vendore derisa EULEX-i është përqendruar në disa raste të profilit të lartë meqë sjellja kriminale po rrezikonte funksionimin e shtetit dhe/ose stabilitetin e institucioneve publike.⁴⁸ Edhe pse ka sasi të pajustificueshme të pasurisë në elitën e tanishme politike asnjë hetim deri më tani nuk ka çuar në aktakuzë dhe konfiskim të pasurisë së fituar me sjellje korruptive.

Hetimet që ishin ndërmarrë nën udhëheqjen e EULEX-it nga komandanti i fundit ushtarak francez u kritikuan nga gjykata e EULEX-it përballë një rasti të ndjekur nga EULEX-i pasi kishte pasur hetime selektive në dënimin e rasteve të posaçme.⁴⁹ Arrestimet e disa rasteve të profilit të lartë gjithashtu janë përcjellë shpesh me informata lidhur me arrestimet, me raportime sensacionale të mediave sikurse me arrestimin e ish-Sekretarit Permanent të Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Tolaj (i zgjedhur gjatë kohës së Ministrisë të LDK-së, Alush Gashi), arrestimi i Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Prishtinës z. Sami Hamiti ose të ish-gubernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, i cili ishte shfaqësuar nga të gjitha akuzat nga një gjyqtar i EULEX-it në nivelin e Gjykatës së Qarkut. Në rastin e arrestimit të ish-Sekretarit Permanent në Ministrinë e Shëndetësisë, Kryeministri i Kosovës e komentoi arrestimin si një rezultat të prioriteteve të tij për ta luftuar korrupsionin. Me fillimin e luftës kundër korrupsionit fillimisht me partitë opozitare apo figura të tjera më të dobëta si në rastin e z. Limaj, të mbuluara me raportime sensacionale të medieve çuan në deklarata spekulative të figurave politike⁵⁰ mbi gjendjen lidhur me hetimin e rasteve të korrupsionit.

Dyshime për politikën prapa hetimeve të korrupsionit në Kosovë janë vërejtur në të kaluarën. Më 2010, Komisioni Evropian raportoi se Drejtoria kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit e ngarkuar me hetimin policor të krimeve ekonomike dhe korrupsionit, i është nënshtruar ndërhyrjeve politike.⁵¹ Në procesin gjyqësor të EULEX-it kundër Fahredin Gashit, i dënua me 18 vjet burgim për krime lufte, dëshmitari bashkëpunues i rastit Nazim Bllaca kishte dhënë deklarata se zyrtarë të Policisë së Kosovës (p.sh. Drejtori i tanishëm i Drejtorisë për Hetime të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Policinë e Kosovës) kishte fshehur deklaratën e tij kur e kishte dhënë në PK për vrasjet e kryera në emër të një agjencie ilegale të inteligjencës e njohur

⁴⁷ Burim i KIPRED, ish staf i EULEX-it, 2011.

⁴⁸ Shih nenin 10 të Ligjit të Kosovës mbi Zyrën Speciale të Prokurorisë së Kosovës, në http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=143&Itemid=56&lang=en.

⁴⁹ Shih Gjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër Z. Bukoshi, Z. Tolaj dhe të tjerëve, kritika e Gjykatës Peck prokurorit të EULEX për hetime selektive të rastit, fq.30

⁵⁰ Shih p.sh. deklaratën e kreu të partisë LDK Z. Isa Mustafa mbi arrestimin e kreu të Kuvendit Komunal, Artikulli 'Isa Mustafa deklarohet pas arrestimit të Sami Hamiti' në <http://www.kohaditore.com/?page=1,13,115294>

⁵¹ Shih fq.12 dhe 56 të Raportit të Progresit të KE për Kosovën 2010.

si Shërbimi Informativ i Kosovës SHIK.⁵² Kjo deklaratë u dha gjatë procesit gjyqësor të udhëhequr nga prokurori i EULEX-it kundër Fahredin Gashit. Më 2011 si rezultat i deklaratave se zyrtarë të lartë të policisë janë të anëtarësuar në struktura të ndryshme ilegale të inteligjencës në Kosovë, Ministri i Punëve të Brendshme z. Rexhepi bëri një numër ndryshimesh në strukturën e Policisë së Kosovës. Sidoqoftë, pas disa muajsh zyrtarët e përfolur të policisë ishin kthyer në të njëjtat pozita udhëheqëse.

Ngjashëm më 2013 KE vëren se po vazhdojnë lidhjet e afërta në mes të udhëheqësisë së Policisë së Kosovës dhe nivelit politik.⁵³ Më tej raporti konstaton se Task-Forca Anti-Korrupsion e Kosovës vazhdon me muaj të ndjejë mungesën e dy nga pesë prokurorëve vendor duke ngadalësuar hetimet për një nga mekanizmat më të rëndësishëm shtetëror për të luftuar korrupsionin sidomos për rastet e profilit të lartë. Emërimet e përkohshme, mungesa e zyrave dhe pajisjeve themelore vazhdon të pengojë kryerjen efikase të mandatit të kësaj task-force.⁵⁴ Krahasuar me këtë, Drejtorja për Krime Ekonomike dhe Korrupsion e Policisë së Kosovës është mbështetur nga qeveria dhe i janë ofruar burime të mëdha njerëzore me pothuajse 100 e më shumë hetues.⁵⁵ Prandaj, shumica e të dhënave të ofruara nga PK po shfaqin një rritje të rasteve të hetuar për krime të lidhura me korrupsionin.

C) Sfidat e vazhdueshme në zbatim

Gjatë periudhës Janar-Gusht 2013, 117 raportime penale të rasteve të reja të korrupsionit ishin dërguar te prokurorët nga Departamenti i Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit i Policisë së Kosovës.⁵⁶ Shumë nga rastet e raportuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë treguar se gjatë periudhës Janar-Korrik 2013 në total ishin 560 raportime penale kundër korrupsionit në të gjitha nivelet e shërbimeve prokuroriale të Kosovës.⁵⁷ 51% të rasteve ishin trashëguar nga vitet e kaluara të raportimeve penale. Nga rastet e mbetura, në vetëm 13.1% të rasteve është ngritur aktakuza dhe më shumë se 42% të rasteve janë mbyllur ose të hedhur poshtë. Kjo tregon se “autonomia” e re në hetimin e rasteve të korrupsionit nga policia vazhdon të shfaq mungesë të bashkëpunimit me prokurorinë nga fillimi i hetimeve siç kërkohet nga kodi i ri penal dhe kodi i procedurës penale.

Rritja e statistikave të hetimit të rasteve të korrupsionit nuk ka dhënë shumë rezultate në anën e hetimeve financiare. Ndërsa në Kosovë shumica të mëdha parash vazhdojnë të investohen në biznese të pasurisë së patundshme, kazino ose biznese ndërtimi shpesh të dyshuara për iniciativa të pastrimit të parasë. Hetime të pakta dhe përcjellje të dobëta gjyqësore janë bërë në raport me shpëlarjen e parave dhe krimeve që nderlidhen me të. Siç vërehet nga Raporti i Progresit i KE ka pasur ngurrim nga agjencitë për zbatimin e ligjit për të filluar hetimet financiare, duke rezultuar me një numër të ulët të konfiskimeve dhe sekuestrimeve të urdhëruara nga gjyqësori dhe zbatime nga policia.⁵⁸

⁵² Shih <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0207.php>

⁵³ Shih fq.49 të Raportit të Progresit të KE për Kosovën 2013.

⁵⁴ Raporti i Progresit për Kosovën 2013,

⁵⁵ Takimi i KIPRED me kreun e Departamentit të Drejtoratit të Policisë së Kosovës për krime ekonomike dhe korrupsion, shtator 2013.

⁵⁶ Komunikim me e-mail i KIPRED me Drejtoratin për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, gusht 2013.

⁵⁷ Raporti i Njesisë për Vlerësimin e Performancës së Kosovës lidhur me performancën e Prokurorisë Themelore, Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë Shtetërore (Gjysma e Parë e 2013) në http://www.psh-ks.net/repository/docs/Comprehensive_Report_for_all_Basic_Prosecutions.pdf

⁵⁸ Shih fq. 50 të Raportit të Progresit për Kosovën, 2013.

Nismat e fundit prokuroriale për të zbatuar një sistem të konfiskimit dhe menaxhimit të pasurisë janë kryer pa një bazë të qartë ligjore. Sipas Nenit 112 të Kodit të Procedurës Penale artikujt e marrur gjatë një kontrolli të urdhëruar nga gjykata mund të sekuestrohen. Ata artikuj mund të konfiskohen vetëm nëse janë listuar në aktakuzë dhe nëse është deshmuar në proces gjyqësor se kanë lehtësuar shkeljen penale apo kanë rezultuar si përfitim material nga krimi i kryer. Prokurori i Shtetit në Shkurt 2013⁵⁹ urdhëroi prokurorët themelor që pasuria e sekuestruar duhet të jetë nën mbikëqyrjen dhe administrimin e Prokurorit të Shtetit, e menaxhuar nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara (AAPKS). Urdhri është dërguar për implementim të menjëhershëm në Policinë e Kosovës, Doganat dhe AAPKS.

Në shkeljet flagrante të kërkesave ligjore ky urdhër është konstatuar të jetë shkelje e plotë e Kodeve Penale⁶⁰ të miratuara së fundmi. Në kundërshtim me kërkesat sipas Nenit 264 të Kodit të Procedurës Penale sekuestrimi i përkohshëm mund të lëshohet nga prokurori vetëm një herë për një maksimum prej 72 orësh. Ngjashëm Neni 112.2 i Kodit urdhëron që pas 5 ditësh gjykata duhet ta konfirmojë urdhrin për konfiskim të përkohshëm të urdhëruar nga prokurori. Në komunikim me KIPRED-in, Prokurori Shtetëror ka konfirmuar se gjatë periudhës Janar-Qershor 2013 ka qenë vetëm një rast i kërkesës nga prokurori tek një gjykatës për sekuestrim në një rast të lidhur me korrupsion.⁶¹ Nga raportet e AAPKS në periudhën Janar-Qershor 2013 agjencia ka pasur 14 vendime për sekuestrim dhe konfiskim nga trupa të ndryshëm. Misioni i EULEX-it kishte vetëm një urdhër për konfiskim të dorëzuar në Agjenci.⁶²

Në vlerësimin e efikasitetit të hetimeve dhe ndjekjes penale së korrupsionit analiza tregon se statistikën e detajuar duhet të zërthehen me të dhënat matëse të rasteve nga fillimi i rastit deri në fund me një numër të rasteve që kanë sjellur dënime. Kosova deri më tani nuk ka marrë masa për një sistem të tillë. Për më tepër, bazat ligjore sipas kodeve të reja penale kanë treguar rezultate të ulëta të zbatimit me trupat e mandatuar që koordinojnë dhe zbatojnë në mënyrë minimale dispozitat e reja ligjore. Kosova duhet që ti shqyrtojë me kujdes legjislacionin dhe mekanizmat e tanishëm për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar duke i kushtuar vëmendje nevojës së menjëhershme për të adresuar hetimet në rritjen e pajustificueshme të pasurisë siç është vërejtur nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Reformat e fundit ligjore dhe institucionale nuk kanë çuar në rezultate të prekshme në rritjen as të hetimit e as të ndjekjes penale së rritjes së pajustificueshme të pasurisë në Kosovë. Masat e konfiskimit të dekretuara rishtas vonohen në zbatim, të përcjella nga mungesa e vullnetit të spektrit politik për të mbështetur zhvillimin e agjencive për zbatimin e ligjit dhe gjykatave të paanshme, profesionale dhe autonome.

V. RRUGA PËRPARA

Vazhdimi i pasurimit të paligjshëm dhe mungesa e hetimeve lidhur me pasurinë e pajustificueshme të krijuar në Kosovë gjatë viteve të kaluara vazhdojnë të jenë veçanërisht dëmtuese për krijimin e institucioneve demokratike, dhe një ekonomie kombëtare të bazuar në parimet e sundimit të ligjit në Kosovë. Përpjekjet e pandërprera për të përmbushur kërkesat e 'porositura' të BE-së në fushat e sundimit më të gjerë të ligjit dhe qeverisjes së mirë, posaçërisht lufte kundër korrupsionit, mund të arrihen vetëm nëse ekziston një vullnet i fortë politik i

⁵⁹ Urdhri i Prokurorit të Shtetit Nr. 49, datë 20 shkurt 2013.

⁶⁰ Shih analizën e ekspertëve të BE-së mbi Analizën Ligjore të legjislacionit për konfiskim dhe sekuestrim dhe Ligji mbi Administrimin e pronës së Sekuestruar dhe Konfiskuar, Asistencë Teknike e BE-së për Kosovën, korrik 2013. Copy me KIPRED.

⁶¹ Komunikim me e-mail i KIPRED me zyrtarë të Prokurorisë së Shtetit, qershor 2013.

⁶² Komunikim me e-mail i KIPRED me zyrtarë të MD, gusht 2013.

përkrahur me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për autoritetet gjyqësore, transparencë dhe shmangien e ndikimit politik në kapacitetet hetuese.

Dështimi i trajtimit me efikasitet të fenomeneve të korrupsionit është ngushtë i lidhur me aspektet politike. Korrupsioni është i pranishëm në nivelin e lartë të qeverisjes por hetimet nuk kanë qenë proporcionale. Duke e mbrojtur shpesh stabilitetin institucional përmes qasjes së normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë çuar në një mbështetje të fuqishme të komunitetit ndërkombëtar për dialogun politik që po vazhdon. Dialogu e ka lënë elitën e korruptuar politike të paprekur nga kushtet e BE-së me të cilat është bërë pazar kundrejt zbatimit të kërkesave të BE-së sipas marrëveshjeve politike. Kërkesat e BE-së nuk duhet të fokusohen vetëm në të dhënat e rasteve por gjithashtu duhet të masin suksesin në luftën kundër korrupsionit, kundër pavarësisë dhe autonomisë së strukturave juridike dhe ato për sundim të ligjit. Vetëm strukturat e pavarura dhe autonome do të mund të garantojnë përkrahjen e institucioneve të qëndrueshme që punojnë në interes të shtetit e jo vetëm të një elite të caktuar politike. Nëse vazhdon të ofron pandëshkrueshmëri për elitën e saj politike, Kosova do të rrezikoj të dështon si shtet. Mungesa e përparimit të Kosovës si një shtet i bazuar në sundim të ligjit dhe mbi parimet e shtetit demokratik, jo vetëm se do të pengojnë sigurinë e qytetarëve të Kosovës, por edhe do të vazhdojnë të paraqesin rrezik për sigurinë e BE-së.

- Kosova duhet ta marrë në konsideratë nevojën për përmirësim të sistemit të saj ligjor duke inkorporuar rregullore të mëtjshme dhe të marrë në konsideratë zhvillimin e sistemit të parandalimit për kapjen dhe konfiskimin e pasurisë së arritur nga veprimet e paligjshme nga personat që i përkasin organizatave të tipit të mafias. Në këto raste Kosova duhet të marrë në konsideratë përdorimin e pasurive kriminale të konfiskuara dhe t'i kthej për nevojat e interesave shoqërore p.sh. fonde shoqërore.
- Edhe në rastet kur nuk janë vendosur dënimet penale, Kosova duhet të marrë në konsideratë konfiskimin *in rem* të pasurisë së fituar nga krimi bazuar në standardin e ligjit civil për balancimin e mundësive më shumë se në standardin penal të përtej çdo dyshimi të arsyeshem. Kjo do të zhvendoste peshën e provës tek pala e dyshuar dhe do ta rriste mundësinë e zbatimit të ligjeve për konfiskim nga institucionet e sundimit të ligjit.
- Në mënyrë që të goditen në procedura dhe pasuri të krijuara gjate viteve te fundit në Kosovë si rezultat i pandëshkueshmërisë nga ndjekja penale e elitës së korruptuar politike, kapacitetet hetuese të prokurorisë së tanishme do të duhej të mbështeteshin në të njëjtën linjë me praktikatat më të mira aktuale të BE-së duke ofruar burime të mjaftueshme njerëzore dhe buxhetore për agjenci autonome dhe të pavarura të zbatimit të ligjit; Kosova duhet të marrë në konsideratë garancitë ligjore dhe kushtetuese për sigurimin e pavarësisë dhe autonomisë të prokurorëve dhe gjyqtarëve duke e rishikuar gjithashtu pasqyrën strukturale mbi menaxhimin e policisë bazuar në merita;
- Origjina e pasurisë duhet të deklarohet dhe të vërtetohet plotësisht nga AKK në pajtim me Ligjin për Deklarimin e Pasurive dhe kërkesave të reja të Kodeve Penale duke zbatuar në tërësi legjislacionin dhe duke i dhënë fund pandëshkueshmërisë me anë të verifikimit të pasurisë së të gjithë zyrtarëve të lartë dhe duke urdhëruar pagesën e plotë të dëmeve të shkaktuara me deklarin e falsifikuar të pasurisë nga gjykatat;

- Në linjë me negociatat në vazhdim të kapitujve për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit në BE, BE-ja duhet të vazhdojë të kushtëzojë institucionet e Kosovës duke kërkuar reformë të brendshme bazuar në praktikat më të mira të BE-së për të garantuar pavarësinë e plotë dhe autonominë e strukturave hetuese, prokuroriale dhe gjyqësore. Duhet të ekzistojë një ri-fokusim i madh në përmbushjen e kriterit të sundimit të ligjit duke e përfunduar traditën e pandëshkueshmërisë të zyrtarëve të lartë për shkak të fokusimit të vetëm në marrëveshjet politike për zbatimin e marrëveshjes Kosovë-Serbi. Nëse vazhdohet ashtu shtetësia e Kosovës do të vazhdojë të dezintegrohet dhe të konsiderohet një rrezik për sigurinë e BE-së në planin afat-gjatë.

ANEKSI 1.

Tabela 1: Pasuria e përgjithshme/Ministrat e Kabinetit Qeveritar

Pasuria e Përgjithshme e Anëtarëve të Kabinetit Qeveritar							
Emri dhe Mbiemri	2010	2011	Ndryshimi nga viti paraprak	2012	Ndryshimi nga viti paraprak	2013	Ndryshimi nga viti paraprak
	Pasuria Totale	Pasuria Totale		Pasuria Totale		Pasuria Totale	
Hashim Thaçi	988,827.00	886,742.00	-10%	807,918.00	-9%	792,783.00	-2%
Behgjet Pacolli		171,829,448.93		192,446,753.73	12%	294,979,567.83	53%
Mimoza Kusari-Lila		350,860.00		458,401.64	31%	341,049.13	-26%
Hajredin Kuçi	508,336.00	492,672.00	-3%	527,672.00	7%	510,932.00	-3%
Mahir Yagcilar	292,688.00	258,960.00	-12%	255,182.10	-1%	227,939.97	-11%
Slobodan Petrovic	215,520.00	166,500.00	-23%	183,981.00	10%	203,181.00	10%
Ramë Buja	348,118.00	353,960.00	2%	365,520.00	3%	310,520.00	-15%
Blerand Stavileci	209,887.00	262,469.00	25%	257,769.00	-2%	247,170.00	-4%
Ibrahim Makolli	201,620.00	96,060.00	-52%	93,901.64	-2%	93,801.64	0%
Bedri Hamza	262,464.00	222,280.50	-15%	285,545.17	28%		
Agim Çeku		665,048.00		659,848.00	-1%	651,381.00	-1%
Fehmi Mujota	235,678.00	330,841.00	40%	310,572.00	-6%	315,872.00	2%
Memli Krasniqi	155,256.00	160,180.00	3%	70,060.00	-56%	160,860.00	130%
Dardan Gashi		1,353,400.00		1,353,400.00	0%	1,337,400.00	-1%
Nenad Rasic	642,540.00	848,700.00	32%	940,056.00	11%	948,406.00	1%
Bajram Rexhepi	391,000.00	339,600.00	-13%	319,000.00	-6%	393,000.00	23%
Enver Hoxhaj	321,877.00	309,803.42	-4%	253,324.00	-18%	332,448.00	31%
Ferid Agani		346,461.00		313,563.00	-9%	396,055.00	26%
Vlora Çitaku	182,120.00	166,746.00	-8%	161,746.00	-3%	163,446.00	1%
Dalibor Jevtic						543,026.00	
Besim Beqaj	2,555,343.42	1,071,680.00	-58%	1,219,680.00	14%	995,180.00	-18%
Edita Tahiri	572,566.00	565,255.00	-1%	553,375.00	-2%	561,790.60	2%

Tabela 2: Pasuria e përgjithshme e deputetëve të Kuvendit të Kosovës të zgjedhur sipas rastit

Pasuria e përgjithshme e Deputetëve të Kuvendit							
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	2010	2011	Ndryshimi nga viti paraprak	2012	Ndryshimi nga viti paraprak	2013	Ndryshimi nga viti paraprak
	Pasuria Totale	Pasuria Totale		Pasuria Totale		Pasuria Totale	
Adem Grabovci	1,662,500.00	1,683,426.12	1%	1,684,016.46	0%	1,388,246.00	-18%
Jakup Krasniqi	536,880.00	443,247.00	-17%	453,104.26	2%	433,104.26	-4%
Xhavit Haliti	268,863.80	1,419,822.00	428%	1,422,807.50	0%	1,409,649.65	-1%
Fatmir Limaj	1,035,530.00	1,096,078.00	6%	1,002,678.00	-9%	993,138.00	-1%
Azem Sylja	n/a	244,006.00	n/a	290,496.15	19%	219,304.00	-25%
Fatmir Xhelili	n/a	631,700.00	n/a	625,000.00	-1%	619,400.00	-1%
Shaip Muja	n/a	2,355,880.00	n/a	2,355,880.00	0%	2,308,560.00	-2%
Blerta Deliu	n/a	n/a	n/a	2,865,000.00	n/a	2,864,118.00	0%
Bekim Haxhiu	n/a	450,743.00	n/a	467,057.00	4%	464,079.00	-1%
Justina Shiroka -Pula	820,083.90	1,060,482.00	29%	1,219,151.00	15%	1,122,997.32	-8%
Ramiz Lladrovci	n/a	251,286.20	n/a	226,489.20	-10%	158,122.40	-30%
Arsim Bajrami	499,640.00	378,600.00	-24%	379,050.00	0%	398,300.00	5%
Hasime Krasniqi	n/a	327,524.00	n/a	346,560.00	6%	439,540.00	27%
Idriz Vehapi	281,596.00	287,856.00	2%	337,422.00	17%	354,769.00	5%
Latif Gashi	n/a	474,300.00	n/a	484,176.00	2%	420,140.00	-13%
Kurtan Kajtazi	n/a	422,900.00	n/a	512,501.00	21%	451,531.00	-12%
Halit Krasniqi	n/a	1,710,000.00	n/a	1,374,057.32	-20%	478,545.45	-65%
Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	Pasuria Totale	Pasuria Totale	Ndryshimi nga viti paraprak	Pasuria Totale	Ndryshimi nga viti paraprak	Pasuria Totale	Ndryshimi nga viti paraprak
Hashim Dëshishku	n/a	13,120,090.00	n/a	13,390,524.75	2%	12,822,255.00	-4%
Ismet Beqiri	271,084.71	269,565.00	-1%	282,402.00	5%	301,244.00	7%
Naser Osmani	83,000.00	122,000.00	47%	97,240.00	-20%	86,800.00	-11%
Lutfi Haziri	498,730.35	1,784,700.00	258%	1,846,414.00	3%	1,931,243.00	5%
Skender Hyseni	652,646.25	656,438.00	1%	648,382.60	-1%	642,381.52	-1%
Arben Gashi	n/a	236,094.00	n/a	299,845.00	27%	265,270.00	-12%
Lutfi Zharku	362,794.39	365,202.80	1%	380,941.00	4%	505,129.00	33%
Vjosa Osmani	n/a	84,351.00	n/a	192,096.00	128%	1,252,311.00	552%
Bahri Thaçi	n/a	447,300.00	n/a	465,800.00	4%	562,603.00	21%
Teuta Sahatqija	n/a	867,472.32	n/a	884,277.39	2%	898,787.39	2%
Ali Sadriu	n/a	671,200.00	n/a	689,720.00	3%	694,520.00	1%
Sadri Ferati	711,552.00	776,770.00	9%	812,199.00	5%	744,169.00	-8%
Salih Morina	n/a	328,095.00	n/a	329,400.00	0%	331,136.00	1%
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	Pasuria Totale	Pasuria Totale	Ndryshimi nga viti paraprak	Pasuria Totale	Ndryshimi nga viti paraprak	Pasuria Totale	Ndryshimi nga viti paraprak
Ramiz Kelmendi	n/a	91,308,453.31	n/a	78,283,763.31	-14%	50,268,837.39	-36%
Daut Haradinaj	n/a	376,557.02	n/a	205,993.19	-45%	354,315.00	72%
Blerim Shala	n/a	347,981.00	n/a	354,715.00	2%	361,216.00	2%
Ardian Gjini	486,576.00	496,376.00	2%	505,976.00	2%	515,076.00	2%
Burim Ramadani	n/a	820,300.00	n/a	1,008,900.00	23%	1,004,500.00	0%
Bali Muharremaj	n/a	615,400.00	n/a	589,404.15	-4%	589,404.15	0%
Lëvizja Vetëvendosje (VV)	Pasuria Totale	Pasuria Totale	Ndryshimi nga viti paraprak	Pasuria Totale	Ndryshimi nga viti paraprak	Pasuria Totale	Ndryshimi nga viti paraprak
Florin Krasniqi	n/a	10,306,136.00	n/a	11,421,521.00	11%	6,896,116.00	-40%
Rexhep Selimi	n/a	235,906.00	n/a	196,156.00	-17%	196,156.00	0%
Albin Kurti	n/a	19,240.00	n/a	19,240.00	0%	19,240.00	0%
Albana Gashi	n/a	342,856.00	n/a	343,000.00	0%	342,856.00	0%
Afrim Hoti	n/a	305,856.00	n/a	305,856.00	0%	305,656.00	0%